REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 327/19
Datë/Datum. 04.07.19
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES i PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **MASHT** OEankues **"Infinit Engineering SH.P.K & Avduli Përfaqësia në Kosovë"**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Ilir Halili – Ekspert profesional shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr.327/19 të parashtruar nga OE : **"Infinit Engineering SH.P.K & Avduli Përfaqësia në Kosovë"**		
Datë	04.07.2019		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr.04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, dhe Ligjin 05/L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e datës:19.06.2019, me nr.327/19 tëparashtruar nga OE " **Infinit Engineering SH.P.K & Avduli Përfaqësia në Kosovë "-Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit:**"Ndërtimi i shkollës së mesme të ulët në Tilanoc të Muhaxherëve Faza e I-rë Ferizaj"**,me numër të prokurimit: **208 Udheheqesi-19-2668-5-1-1**,tëiniciuar nga Autoriteti Kontraktues(AK)–**MASHT.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MASHT**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **"Infinit Engineering SH.P.K & Avduli Përfaqësia në Kosovë "- Prishtinë.**

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES i PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

RAPORTI i *EKSPERTIT SHQYRTUES*

		25.06.2019	**04.07.2019**
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të ekspertit.*	*data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën:19.06 OE" **Infinit Engineering SH.P.K & Avduli Përfaqësia në Kosovë** "–Prishtinë, ka parashtruar ankesë në OSHP, me nr.**327/19**, kundër njoftimit për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit"**Ndërtimi i shkollës së mesme të ulët në Tilanoc të Muhaxherëve Faza e I-rë Ferizaj"**,me numër të prokurimit: **208 Udheheqesi-19-2668-5-1-1**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)–**MASHT.**

Konform nenit113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Dispozitat e shkelura sipas Operatori Ekonomik ankues"Infinit Engineering SH.P.K & Avduli Përfaqësia në Kosovë "-Prishtinë

Nenin 1,
Neni 6,
Neni 7.6,
Neni 10
Neni 52,
Neni 56.3
Neni 59,
Neni 65,
Neni 69,
Neni 72,
Nenit 108A
Neni 39.8 dhe 49.22 të RUOPP

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Ne si OE i interesuar për këtë aktivitet të prokurimit kemi aplikuar për këtë aktivitet të prokurimit me dt.17.05.2019 dhe kemi dorëzuar ofertën tonë e cila rezulton të jetë me qmim më të ulët ashtu siq është përshkruar në procesverbalin e hapjesë së tenderve dhe siq është kërkuar në DT si kriter për dhënien e kontratës tenderi i përgjegjshëm me qmim

më të ulët.

Nga AK me dt. 31.05.2019 kemi pranuar njoftimin për eliminimin përmes letrës standarde për tenderuesit e pa sukseshëm,

Me dt. 04.06.2019 kemi parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim konform nenit 108A të LPP-së pranë AKpër tenderin: "Ndërtimi i ohjekteve shkollore Zaskok Ferizaj.Doganaj Kaçanik dhe Talinoc Ferizaj" Grupi 3: "Ndërtimi i shkollës së mesme të ulët në Talinoc i Muhaxherëve Faza e 1-re, Ferizaj"me nr.të Aktivitetit tëprokurimit:208-19-019-51 l.AK me dt10.06.2019 refuzon kërkesën ton si të pa hazuar duke lënë në fuqi vendimin për dhënje të kontratës OE: "N.P.N. BAJRAMAJ; ARBËRI -NSSH.P.K., SAVROVË, 23000, SUIIAREKË".

Ne si OE i intresuar për këtë aktivitet të prokurimit në kërkesën tonë kemi kundërshtuar fuqishëm arsyet e eliminimit nga ky tender ku AK si arsye të eliminimit ka potencuar si më poshtë:

-Lideri i Grupit të Operatorëve Ekonomik "A VDULI" sh.pk. me seli në Prishtinë, dega në Kosovë, më parë ka pasur të nënshkruar kontratë me MASIIT, "Ndërtimi i murit mhrojtës në Kaçanik" me nr. Të Prokurimit; MASIIT/12/053/511, të cilën kontratë OE në jjalë nuk e ka përmbushur ende, qe nga viti 2012. Menaxheri i kontratës, ka parashtruar dhjelra kërkesa drejtuar kontraktuesit në fjalë për tapërmbushur kontratën. Njëjt menaxheri i kontratës ka bërë një rekomandim për shkëputjen e kontratës së lartëcekur, pasi që konsideron se OE nuk dëshiron përmhushjen e kontratës.

- Grupi i OE, kanë prezantuar staf profesional, ku si dëshmi ka prezantuar Diploma të cilat janë të lëshuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri. Asnjëra nga diploma e stafit profesional nuk është e Nostifikuar në Kosovë, me çka i bënë të pavlefshme pasi që nuk kanë të drejtë të ushtrojnë veprimtarinë profesionale person me diplomë të huaj pa ju nënshtruar procedurës së verifikimit dhe nostifikimit të kualifikimit shkollor përkatës.

- Lideri i konzorciumit nuk ka prezantuar asnjë referencë të lidhur me përmhushjen e kontratave në 3 vitet e fundit në Kosovë, të gjitha referencat e prezantuara janë të kontratave të realizuara në Shqipëri.

Krahas këtyre arsyeve për eliminim sipas letres standarde për tenderuesit e pasukseshëm AK gjatë fazës së ri-shqyrtimit,në vendimin për refuzim të kërkesës për ri-shqyrtim na njofton se nuk kemi plotësuar edhe kërkesat tjera të DT në veqanti lidhur me ceqrtifikatat ISO kinse nuk kanë validitet se janë me afat të skaduar.

Është për të ardhur keq profesionalizmi,tendenca dhe këmbngulësia e AK që me qdo kusht të diskriminoj një OE dhe të favorizoj një tjetër.

Po ju njoftojmë se ne kemi pranuar letren standarde për eliminim me dt. 31.05.2019 dhe po ashtu me të njejtën datë me 31.05.2019 përmes letrës standarde për tenderuesit e sukseshm njoftohemi se tenderues i sukseshëm për këtë AK është OE"N.P.N. BAJRAMA.J;ARBËRI -NS SH.P.K, SAVROVË, 23000, SUHAREKË". Ashtu si ju njoftuam ne kemi dorëzuar kërkesën për ri shqyrtim ku AK Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë me dt.10.06.2019 refuzon këtë kërkes me qka bënë:

-Shkelje esenciale të dispozitave të LPP-ës dhe

- Vërtetim të gabuar të gjendjesë faktike.

Ne si OE pjesmarrës në këtë aktivitet të prokurimit nuk pajtohemi me këto njoftime dhe refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim sepse AK ka vepruar në kundërshtim me dipozitat e lartë cekura të LPP-ës.

Nuk pajtohemi me eliminimin nga ky aktivitet i prokurimit.dhe arsyet e refuzimit të kërkesës për ri-shqyrtim sepse arsyet e cekura nga AK janë të pa vërtetajo profesionale dhe irituese,nga këto shifet tendencë për eliminim dhe shpërblim me kontratë të OE të caktuar,më posht gjeni përgjigjet tona të bazuara në prova dhe ligj për secilën arsye të elimimit.

*Lidhur me arsyen e parë AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 65 të LPP-së nr.04/L-042 për të shpallur një OE të pa përshtatshëm apo për ta përjashtuar nga aktiviteti i prokurimit duhet të plotësohen një sërë kushtesh këtë e rregullon dispozitat e këtij neni këtë qështje dhe atë citat i këtij neni 65.3.2: "është deklaruar i papërshtatshëm, kur autoriteti kontraktues zbulon se kjo është një shkelje e rëndëprofesionale;"kjo dispozit është plotësuar dhe ndryshuar LPP nr.05/L-068 i cili ligj e sanksionon dhe eplotson me me paragrafin "E KONSTATUAR NGA NJË GJYKATË KOMPETENTE"nga kjo rezulton se AK nuk ka dëshmuar se ka një vendim apo aktgjykim e cila ka konstatuar ndonjë shkelje të rëndë profesionale për të na klasifikuar si OE të pa pranueshëm dhe eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, po ashtu nga AK asnjëherë nuk ka kemi pranuar vërjtje,penalitete gjatë implementimit të konlratës e po ashtu nuk kemi pranuar as kërcnim për shkëputjen e konttratës dhe as padi në gjykatën kompetente.
Ne nuk e dijmë dhe nuk jemi të informuar nga AK se në cilën dispozit të këtij Ligji AK është mbështetur për të na eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit për këtë pikë të arsyetimit të eliminimit sepse Ligji është i qartë vetëm nëse e konstaton ndonjë gjykatë kompetente edhe nëse referenca është negative,edhe nëse ka vrejtje por edhe ajo më e keqja që nëse ka shkëputje të kontratës duhet të jetë një vendim apo aktgjykim i Gjykatës Kompetente që ka konstatuar këtë sepse këto mund të jenë subjektive të njëanshme dhe për këtë Ligji ka parashikuar që duhet të jen të konstatuara nga Gjykata Kompetente.
Ne jemi të interesuar për përmbushjen e kësaj kontrate dhe duhet të ekzistoj edhe një vullnet i AK sepse nuk qëndronë arsyetimi i AK se kjo mospërmbushje e kontratës është vetëm mefajin tonë shtrohet pyetja pse atëherë AK nuk e shkëputë kontratën dhe pse nuk ngit padi në gjykatë nëse nejemi fajtor por ne jemi të interesuar që kontrata e vitit 2012 të përmbushet sepse ne asnjëher nuk jemi deklaruar për mos përmbushje asht siq thirret AK.

*Arsye e dytë në të cilën thirret AK për eliminimin tonë është se OE ka prezentuar staf profesional ku si dëshmi ka prezantuar Diploma të cilat janë të lëshuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri. Asnjëra nga diploma e stafit profesional nuk është e Nostifikuar në Kosovë,është për keq ardhje ky lloj arsyetimi i AKju lutem në cilin paragraf faqe e Njoftimit për kontratë dhe e DT është kërkuar që stafi profesional është dasht ti ketët diplomat të nostrifikuara po ju përkujtojmë dëshmin nga AK sipas DT dhenjoftimit për kontratë.
Dëshmial-7 Për menaxherin e Projekti,Personelin Kryesor Teknik të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuara , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Për udhëheqësin e punimeve dhe personelin teknik diplomat duhet të jetë te noterizuara. Dëshmia 6 mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapacitetve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), e noterizuar nga Noteri, O.E. duhet të sjell dëshmi librezat e mjeteve të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt duhettë verifikohen nga noteri. që AK lëshohet në këso vlersime të ulta e në veqanti.

Nga kërkesat dhe dëshmia e kërkuar si në DT ashtu edhe në njofiimin për kontratë nuk gjejmë se stafi duhet të ketë diplomat e nostrifikuara nga institucioni kompetent në Republikën e Kosovës nëse stafi është i ndonjë Shteti tjetër, nga dëshmia e kërkuar kërkesë ka qenë vetëm noterizimi i këtyre dokumenteve tek noteri dhe asgjë mashumë.nga ne nuk është kërkuar nostrifikimi dhe nuk kemi qenë të detyruar të bëjmë një gjë.
AK me këtë ka vepruar në kundërshtim me nenin 7.6(v)dhe (vi) citat: " (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përzgjedhjes ose dhënies, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur tëpërputhet me të gjitha aspektet
përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse. "

Po ashtu edhe dispozitate nenit 56.3 e qartësojnë këtë qështje sepse nuk mund të vlersohet të eliminohet apo rekomandohet një OE për kontrat për një kërkes.kriter apo specifikim i cili nuk ka qenë kërkesë e DT dhe njoftimit për kontratë citat i kësaj dispozite:
" 3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Neni 59.4poashtu e trajton dhe rregullon këtë qështje citat:" Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi nëfjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.....".

Është shumë e qartë se AK ka bërë shkelje të këtyre dispozitave të LPP sepse nuk mund OE të elimohet për diqka që nuk ka qenë e kërkuar në DT dhe njoftimin për kontratë.

Lidhur me këtë kemi qenë të detyruar ti drejtohemi KRPP për të kërkuar opinion ligjor të cilët konform nenit 87 paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Pitblik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 me dt.03.06.2019 na dërgon opinionin lidhur me këtë qështje shihë parashtresën e KRPP si provë:

*Të n*deruar,

Konform nenit 87, paragrafit 2, nënparagrafit 2.8 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në të dhënat e shkresës suaj, KRPP, ofron interpretimin ligjor si në vijim:

Sipas nenit 87 të këtij ligji, përveç interpretimit të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP në bazë të autorizimeve qëi janë dhënë me këtë ligj, në funksion të KRPP-së nuk është edhe interpretimi dhe/ose vlerësimi dhe krahasimi i dëshmive të kërkuara nga AK në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, sepse vendosja e kërkesave, kritereve kushteve specifikimeve apo dëshmive në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë është kompetencë dhe përgjegjësi e plotë e Autoritetit Kontraktues, gjithnjë të specifikuara konform LPP dhe akteve dytesore te prokurimit.

Sipas nenit 59 të këtij ligji, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është kompetencë dhepërgjegjësi eplotë e Autoritetit Kontraktues.

Paragrafi 4 i nenit 59 të këtij ligji, përcakton, citojmë:
"4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit "...

Gjithashtu, Paragrafi 3 i nenit 56 të LPP-së përcakton si në vijim:
"Tenderuesi, gjatëprocedurave të hapura, ose kandidati, gjatëprocedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit".

Për të gjithë OE-të që pretendojnë se AK nuk ka vlerësuar tenderët në përputhshmëri me kërkesat këtij ligji dhe legjislacionit dytësor, si dhe në përputhshmëri me kërkesat e parashtruara në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë, LPP ka paraparë mjetet juridike për t'i atakuar vendimet e AK-së (nenet 108/A dhe 109 të LPP-së).

Ju pershendeism,
Abdyl Limani-ekspert iprokurimit
D.Rregullave ne KRPP

Nga kjo shifet qartë se AK ka dështuar me rastin e vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderve në atë mënyrë duke bërë shkelje të dispozitave të lartë cekura të LPP-së nga kjo mund të konkludojmë se vlersimi ka qenë subjektiv dhe jo profesional i ofertave dhe tttt

*Si arsye tjetër e eliminimit tonë ka qenë se Lideri i konzorciumit nuk ka prezantuar asnjë referencë të lidhttr me përmbushjen e kontratave në 3 vitet e fundit në Kosovë, të gjitha referencat e prezantuara janë të kontratave të realizuara në Shqipëri ju lutem kjo është në kundërshtim me nenin 7 të LPP barazia në trajtim dhe jo-diskriminim,në DT dhe NJK nuk është kërkuar që OE jo rezident në Kosovës duhet të dorëzoj referenca të kontratve të përmbushura në 3 vitet e fundit në Kosovë.
Nga njoftimi për kontratë dhe DT nuk gjejmë se OE kanë qenë të detyruar të dëshmojn referenca për përmbushjen e konttratave në tri vitet e fundit në Kosovë për ta kjartësuar këtë po ju përcjelli Dëshmin 7:

"7 Lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin ekontratave në vlerë totale Lot I- 2,250,000.00€. Lot II- 1.950.000.00 €. Lot III- 2,250,000.00€.Të gjitha,referencat kopje tëpuneve të ngjajshme të realizuara në tri vitet e shkuara".

Pra nuk gjejmë se OE duhet të dëshmoj referenca për kontratat e realizuar në Kosovë ,njejte është edhe tek kërkesat nuk ka kërkesë të tillë.

Edhe me këtë AK ka shkel nenin 7.6 (v)(vi),nenin 56.3 dhe 59.4 të LPP të cilat i cituam më lartë.
E poashtu edhe neni 49.22 i RUOPP e qartëson nenin 56.3 të LPP se si të veprohet dhe udhëzoj AKpër kërkesat dhe kriteret që nuk janë kërkuar në DT.

AK gjatë vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 39 të RIJOPP në veqanti me nein 39.8 të RUOPP duke mos përdorur këtë dispozit ku udhëzohet AK si të veprojë në rastet e caktuara lidhur me sqarimin e tenderit.
Nga ky Udhëzues AK ka të drejtën dhe udhëzohet se mund të kërkohen informata sqaruese,në rastin e referencave dhe të gjitha qështjet për të cilat ka pas hezitime apo paqartësi.
Po ashtu edhe lidhur me referencat AK sipas këtij udhëzuesi në rast se ka pas paqartësi por edhe nëse mungojnë referencat sipas këtij udhëzuesi mund të kërkohet informata sqaruese.
Autoriteti kontraktues me rastin e vlerësimit sepse ne kemi qenë OE me qmim më të ulët dhe AK ka mund të përdor edhe nenit 59 dhe 72 në këtë rast ndaj ofertës tonë.

Pas njoftimit përmes letrave standarde për tenderuesit e pasukseshëm dhe tenderuesit e sukseshëm me dt.31.05.2019 kemi kërkuar nga ana e AK qasje në dokumetet zyrtare me qëllim që të japim vrejtjet tona lidhur me OE të rekomanduar për kontratë përkatsisht OE si i suksessliëm sipas AK.
Edhe për kundër se ne kemi kërkuar qasje në dokumente zyrtare e po ashtu kemi

parashtruar shqetsimet tona lidhur me privimin nga qasja në dokumente -ofertat e OE pjesëmarrës përmes kërkesës për ri-shqyrtim,as në rastin e par por as gjatë ri-shqyrtimit të njejtin nuk japin përgjigjje e as nuk na lejojnë të kemi qasje ashtu siq parashifet me nenin 10 të LPP-së.

Edhe për kundër që ne kemi dhënë pretendimet tona ankimore se AK nuk na ka lejuar qasje në dokumentet zyrtare në afatin kohor para dorëzimit të kërkesës për ri-shqyrtim,ne kemi pritur se gjatë ri-shqyrtimitAk do të përmirsoj një veprim të tyre të kundërligjshëm ai edhe gjatë ri-shqyrtimit fare nuk e arsyeton verimet e veta diskrimin uese.

Autoriteti kontraktues me këtë ka bër shkelje lë dispozitave të nenit 10 të LPP-ës sepse shtyrja e përgjigjesë për qasje në dokumente na privon të bëjmë një ankesë meritore sepse është e pa mundur qp ne ti pasqyrojmë të gjitha vrejtjet dhe shqetsimet tona për OE të rekomanduar për kontratë.Lidhur me këtë ne kemi qenë të privuar të parashtrojmë pretendimet tona ankimore lidhur me operatorin ekonomik tp rekomanduar për kontratë.

Të nderuar nëse shiqojmë përgjigjen-vendimin e AK të dt.10.06.2019 lidhur me refuzimin e kërkesës sonë për ri-shqyrtim gjejmë se asnjë nga pikat ankimore AK nuk <u>është përgjigjur se për cilat arsye nuk qëndrojnë këto pretendime ankimore,por në</u> mënyrë të përgjithsuar jep arsyetimin se janë të pa bazyuar pa specifikuar asnjë pretendim ankimor.

Ju lutem si ka mundësi që AKgjatë ri-shqyrtimit të kërkesës për ri- shqyrtim gjenë se ne nuk kemi plotësuar edhe kërkesa tjera të DT dhe NJK ku tani është një fazë tjetër e jo vlerësim,ekzaminim dhe krahasim të tenderve,AK ka pas për detyrë të jep spjegime vetëm për pretendimet tona ankimore për të cilat ne kemi parashtruar lidhur me arsyet e eliminimit tonë dhe jo të na njoftoj edhe për qështjet tjera të eliminimit ku me letren standarde për tenderuesit e pa sukseshëm nuk kanë qenë tëpërfshira,tani kjo nuk është në fazën e vlersimit kjo është një fazë krejt tjetër dhe AK këto arsye të eliminimit ka qenë i obliguar të na njoftoj me letrën standarde për eliminim dhe ka qenë i obliguar të përgjigjet në pretendimet ankimore për të cilat është parashtruar kërkesa për ri-shqyrtim.

Nga kjo gjejmë se AK nuk ka bërë vlersimin e ofertave konform nenit 59 të LPP dhe vlerësimi ka qenë vetëm sipërfaqsor dhe ka ka qenë i orjentuar vetëm në ofertën tonë me qëllim të eliminimit.

Lidhur me këtë ju njoftojmë si më poshtë:

Pasi kemi parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim me pretendimet tona të lartë cekuar AK ka refuzuar kërkesën për ri-shqyrtim me arsyetimin se.të gjitha arsyet e eliminimit qëndrojnë dhe pretendimet hudhen si të pa bazuara duke shtuar se gjatë ri shqyrtimit kemi gjetur sipas AK tek OE "Avduli" disa certifikata ISO të skaduara dhe atë për certifikatat AQS/QS9002016;EN2.IS0 3834- 2:2006 me këtë nr.e skaduar me dt. 10.04.2019

Për certifikatën AQS/SI 902016:1SO 27001:2013 e skaduar me dt. 10.04.2019 dhe për certifikatën AQS/AS 9032016:180 SA 8000:2014 po ashtu sipas AK e skaduar me dt. 10.04.2019.

Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar të përgjigjet për pretendimet tona lidhur me eliminin sipas letrës standarde për tenderues të pa sukseshëm por jo të gjenë arsye tjera për eliminim në këtë fazë.

Edhe në këtë rast këto arsye nuk qëndrojnë i përcjellim OSIIP përkatsishtë ekspertit shyrtues dhe panelit shqyrtues linkun ku mund të gjenden këto certifikata tek autoriteti kompetent i cili i ka lëshuar për OE "Avduli"ku vetëm duhet të kërkohet përmes nr.të certifikatës si psh.AQS/S143052019 dhe mund të shifet se deri kur janë velide gjeni si më posht linkun:

http://aqscert. org/

Nëse kërkojm në këtë link gjejmë se që të tri këto certifikata ISO kanë validitet deri më 02.06.2022.por AKka qenëparaprakisht ipërcaktuar për rezulltatin final.
Edhe përkundë kësaj AK në rastin kur qmimi është më i ulëtë ka qenë i detyruar të kërkoj informata sqaruese edhe kur mungonë qertifikata ISO sipas nenit 39.8 të RUOPP.AK sikur të kërkonte informa nga ne lidhur me këto certifikata ne kemi qenë të gatshë të prezentojm dhe të sqarojmë këto paqartësi të AK.
Provë:Certifikatat ISO

AK si kriter të saj për dhënien e kontratës është përcaktuar për tenderin e përgjegjshëm me qmim më të ulët ashtu siq e parasheh neni 52 të LPP por në praktik është e kundërta me veprimet e saja AK eliminon ofertën e përgjegjshme me qmim më të ulëtë duke rekomanduar për kontratë OE me qmim më të lartë me që rastë dëmton buxhetin e Republikës së Kosovës me qindra mijra euro.

Nga kjo që u tha më lartë gjejmë se AK me rastin e zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit e kanë përcjell një sërë shkelje të njëpasnjëshme gjatë vlerësimit ekzaminimit dhe krahasimit të tenderve duke anashkaluar qëllimin dhe parimet e prokurimit puhlik për të cilën AK është i thirrur dhe obliguar të zbatoj sipas ligjit.

AK me eliminimin tonë si OE të cilit kemi pas ofertën tonë me qmim më të ulët ka vepruar në kundërshtim me nenin 1 të LPP citat i nenit 1.1 të LPPës:
" 1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese,koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla".

Po ashtu edhe neni 6 i LPP-së i obligon AK të sigurojnë fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë ekonomike citat i nenit 6 të LPP-së:
" Të gjitha auforitetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.
2. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës.

Bazuar në të gjeturat mund të konkludojmë se AK nuk ka pas qëlliin e ruajtjesë së paras publike,ka vepruar në kundërshtim me parimet në të cilat mbështetet prokurimi publik,veprimet e AK qojnë në shkelje të kritereve dhe kërkesave të cilat vetë AK i ka parashikuar në DT dhe njoftimin për kontratë,jo transparenca ka qenë evidente tekë vlersimi i ofertave,AK gjatë tërë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka qenë i një anshëm dhe veprimet e tyre janë dikriminuse dhe favorizuese për OE të caktuar.

Andaj kërkoj nga Paneli shqyrtues i OSHP me rastin e shqyrtimit të ankesësë tonë për aktiviteti i prokurimit"Ndërtimi i objekteve shollore Zaskok Ferizaj.Doganaj Kaçanik dhe Talinoc Ferizaj"
Grupi 3: "Ndërtimi i shkollës së mesme të ulët në Talinoc i Muhaxherëve Faza e I-re

,Ferizaj"me nr.të Aktivitetit lë prokurimit:208-19-019-511 të mer këtë:

VENDIM

1. Aprovohet si e bazuar ankesa e OE"INFINIT ENGINEERING SH.P.K.& Avduli Përfaqësia ne Kosovë" lidhur me aktivilelin e prokurimit për tenderin'Ndërtimi i objekteve shkollore Zaskok Ferizaj,Doganaj Kaçanik dhe Talinoc Ferizaj"
Grupi 3: "Ndërtimi i shkollës së mesme të ulët në Talinoc i Muhaxherëve Faza e I-re ,Ferizaj "me nr.të Aktivitetit të prokurimit:208-l 9-019-511.

2. Anulohet vendimi i AK për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit përtenderin'Ndërtimi i objekteve shkollore Zaskok Ferizaj,Doganaj Kaçanik dhe Talinoc Ferizaj "Grupi 3: "Ndërtimi i shkollës së mesme të ulët në Talinoc i Muhaxherëve Faza e 1-re ,Ferizaj"me nr.të Aktivitetit të prokurimit:208-19-019-511 dhe lënda kthehet në ri-vlerësim.

Dëmet Materiale

Ne konsiderojmë se dëmet materiale janë hurnbja e kontratës me të cilin pësojmë në aspektin financiar,
Shpenzimet e përgaditjesë së tenderit,
Sigurimi i tenderit,
Shpezimet e ankesës.
Largimi nga tregu që për ne paraqet dëm në prespektiv dhe imazh të kompanisë tonë
Fitimi i planiflkuar për këtë tender

Shënim: Pretendimet ankimore te parashtruara ne ankesen e deponuar nga OE ankuese ne OSHP, jane te njëjta me ato të paraqitura me kërkesen për rishqyrtim nga OE ankuesenë AK.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë: 27.02.2019

Lloji i procedurës së aplikuar:.....Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:.....Kontratë publike -furznim/vlerë e mesme

Vlera e parashikuar e kontratës ..... **4.300.000,00€**

Kriteri për dhënie të kontratës(N.52).....tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave.....17.05.2019

Data e hapjes së ofertave.....17.05.2018

Data e njoftimit me letrën standarde 31.05.2019

Data e kërkesës për rishqyrtim.....04.06.2018

Data e vendimit nga AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim.....10.06.2019

Kriteret për vlerësim:

Çmimi më i ulët.

Udhëzimet për Tenderuesit		Përmirësimet/Ndryshimet e Neneve relevante te Informatave për Tenderuesve
Përshkrimi i Nenit	Nr. i Nenit.	
Fusha e tenderit	1.1	Autoriteti Kontraktues (AK) është: **Emri i AK: MINISTRIA E ARSIMIT** **Adresa e AK: RR. AGIM RAMADANI NR. 1** **Qyteti: PRISHTINË** **Kodi Postar: -** **Adresa Elektronike:** **Personi Kontaktues: Arberita Tafilaj** **E-mail: Arberita.Tafilaj@rks-gov.net** **Telefoni: 038 212 879** **Faks:**
	1.2	Titulli i kontratës dhe numri identifikues i aktivitetit të prokurimit është: **Ndërtimi i objekteve shollore Zaskok Ferizaj,Doganaj Kaçanik dhe Talinoc Ferizaj 208 Udheheqesi-19-2668-5-1-1**
	1.3	Data e dorëzimit të Njoftimit të Kontratës në KRPP: **27.04.2019** Versioni i plotë i njoftimit të kontratës të dërguar në KRPP mund të shkarkohet nga faqja elektronike e KRPP-së **ëëë.krpp.rks-gov.net**
	1.4	Tenederi duhet të dorëzohet në adresen e përmendur në 23.1 përveç nëse nuk është e përmedur në 23.1 në adresen e përmendur në 1.1
Qëllimi i Kontratës	2.1	Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP): **45000000-7** Qëllimi i kontratës është ekzekutimi i punëve ne vijim: *[shëno përshkrimin e përgjithshëm të punëve]* **Ndërtimi i objekteve shollore Zaskov Ferizaj,Doganaj Kaçanik dhe Talinoc Ferizaj m2**
Ndarja ne Lote	2.3	Ndarja ne Lote: Po ☒ Jo ☐ *Objekti i tenderit është i ndarë në pjesë (lote) shëno:* Objekti i kontratës është i ndare në **3** pjesë (lote). Tenderuesi mund të paraqesë tender për: ☐ vetëm një pjesë ☒ Të gjitha pjesët Secila pjesë e lot-it është e shënuar në specifikacionet teknike , shih Aneksin 1. Numri maksimal i Pjesëve që do të mund të shpërblehet tek një tenderues është: *[Sheno kriteret objektive dhe jo-diskriminuese apo rregullat për shpërblimin e loteve të ndryshme, ku aplikimi për përzgjedhjen e kritereve për shpërblim do të rezultonte në shpërblimin e një tenderuesi me më shumë lote se sa numri maksimal].*

Vlera e parashikuar	2.4	**4.300.000,00**
Variantet	4.1	*Variantet autorizohen:* Po ☒ Jo ☐ *[Nëse variantet janë të autorizuara, shëno:]* a. Tenderuesit janë të autorizuar që të dorëzojnë një tender duke propozuar një variant që përputhet me një variant të specifikimeve teknike. Tenderuesit duhet të dorëzojnë specifikimet teknike të variantes se ofruar. b. Specifikimet minimale që duhet të përmbushen nga ndonjë variant janë të shënuara në specifikimet teknike të parashtruara në këtë dosje të tenderit, shih Aneksin 1.
Kushtet dhe kërkesat e dërgesës	5.1	Vendi i ekzekutimit te punëve është: **Zaskov Ferizaj,Doganaj Kaçanik dhe Talinoc Ferizaj**
	5.2	Afatet kohore për fillimin dhe / ose përfundimin e kontratës: në muaj **36** ose në ditë ose fillim përfundim
Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	6.4	Përveç deklarates se shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2, dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet Dokumentet te cilat do te kërkohen si dëshmi për përmbushje te kërkesave te pranueshmërise janë me se vijon: a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b,c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate e lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situate tillë nuk ekziston. *c.* Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit *[para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]* Në lidhje me dispozitat e tjera të përcaktuara në Nenin 6 si dhe në rastin kur lëshimi i dokumenteve dhe certifikatave që referohen më lart është i pamundshëm për arsye objektive, apo kur dokumentet nuk mbulojnë të gjitha rastet për të cilat është nxjerrë dëshmia, një deklaratë nën betim nga tenderuesi mund të pranohet si dëshmi e mjaftueshme.
		Kërkesat e përshtatshmërisë: Deklaratë nën betim - Operatori ekonomik duhet ti përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë në pajtim me Ligjin mbi Prokurimin Publik në Kosovë, Ligji Nr. 04 L042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L068 dhe ligjin Nr. 05 L092 Ligjin Nr. 04 L-042, Neni 65 duke përdorur formën në Aneksin 2. 2. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit përpara dorëzimit të tenderit. 3.
		Dëshmia e kërkuar dokumentare: Deklarata nën betim-e nenshkruar dhe e vulosur (ky dokument është pjesë e dosjes) 2. Vërtetimi nga Administrata Tatimore – duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës 3. Vërtetimi nga Gjykata themelore – duhet të dorëzohen vetëm nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës

		Vërtetimi nga Gjykata themelore - Një formular ekstrakt nga "regjistri gjyqësor" apo, në mungesë të kësaj, një dokument ekuivalent të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ i shtetit të themelimit të tenderuesit ku dëshmohet për Seksioni II. FLETA E TË DHËNAVE të Tenderit (FTD) të dosjes se tenderit te Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik, (shiko dosjen e tenderit)	
Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale: Regjistrimi i operatorit ekonomik në regjistrin professional, komercial dhe ose regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit. 2. Regjistrimi i Numrit Fiskal 3. Regjistrimi i TVSH – së4.Certifikate-ISO 9001 2015 valide ,ISO 39001 2012 valide ,ISO 8000-2014 ISO 14001 2015 valide ,OHSAS,18001 2007,valide-ISO IEC 27001 2013 valide ,UNI EN ISO 3834-2 200 valide	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Çertifikata e regjistrimit të biznesit se bashku me informatat për biznesin, te lëshuar nga Autoritetet e Regjistrimit te Biznesit – Kopje. 2. Certifikatën e Numrit Fiskal – Kopje. 3. Certifikatën e TVSH – Kopje. 4. Kopje e noterizuar e Certifikate-ISO 9001 2015 valide ,ISO 39001 2012 valide , ISO 8000-2014ISO14001-2015valide ,OHSAS,18001 2007,valide-ISO IEC 27001 2013 valide ,UNI EN ISO 3834-2 200 valide
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet ti ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik,gjatë tri viteve të shkuara nga data e publikimit të (Njoftimit për Kontrat) duhet te jetë jo më pak për - Lot I V- 3.000,000,00€ - Lot II 2.600,000,00€ - Lot III- 3.000,000,00€ Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 apo me shume pjesë (lote), shuma totale e qarkullimit financiar qe kërkohet për Lotet për te cilat ai konkurron duhet të përmbushet nga OE. Shembull nëse qarkullimi i kërkuar për Lot 1 është 3.000,000,00dhe për Lot 2 është 2.600,000,00, atëherë kërkesa minimale e qarkullimit e cila duhet te përmbushet nga OE është 5,600,000.00 euro,ndersa nëse merr pjesë në tri Loto kërkesa minimale e qarkullimit duhet të jetë 8.600.000,00 € Nëse ky kriter nuk plotësohet në këtë formë OE,do të eliminohet nga të gjitha Llotot pamvarsishtë se ai plotëson kushtet vetëm për një Lot të caktuar. Në rast të grupit për të gjitha Llotot Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar për punë të ngjajshme të realizuara në 3vitet e fundit. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës, mjete të gatshme në llogari, mbështetje nga Banka ose akces në kredi nga Banka për të gjitha Llotot në vlerë prej për Lot I -- 200,000.00 euro Lot II -- 200,000.00 euro Lot III -- 200,000.00	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* Dëshmia 1 Raporti bankar (vërtetim) apo ndonjë dëshmi tjetër zyrtare financiare qe dëshmon qarkullimin financiare për tri vitet të shkuara para publikimit të (Njoftimit për Kontrat) Dëshmia 2 Dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur institucioni bankar lidhur me këtë projekt.
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe professional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare*

		Kërkes 1-7. Menaxher i projektit 1. Inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë ose arkitekturës, me 3 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar. Personeli kryesor teknik 2. Një inxhinier i dip. i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv – 2 vite përvojë pune pas diplomimit. 3. Një inxhinier i dip. i ndërtimtarisë drejtimi hidroteknik – 2 vite përvojë pune pas diplomimit. 4. Një inxhinier i dip. i elektroteknikes – 2 vite përvojë pune pas diplomimit. 5. 1 IËS:inxhinier i dip.i nivelit master me certifikikim IËS international ëelding specialist – 2 vite përvojë pune pas diplomimit 6. Një inxhinier i dip.i makinerisë – 2 vite përvojë pune pas diplomimit. 7. Tre salldues të qertifikuar sipas ISO EN ISO 9606-1 me qertifikata valide	Dëshmia1-7 Për menaxherin e Projektit Personelin Kryesor Teknik të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuara , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Për udhëheqësin e punimeve dhe personelin teknik diplomat duhet të jetë te noterizuara. Dëshmia 6 mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapacitetve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), e noterizuar nga Noteri, O.E. duhet të sjell dëshmi librezat e mjeteve të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt duhet të verifikohen nga noteri.	
		Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 apo me shume pjesë (lote), secilën Loto kërkohet dyfishimi i stafit të kerkuar nese konkuron në tri Loto duhet të trefishoj stafin nese konkuron në katër loto Katër fishimi i stafit, Më kushte të njëjta si në Kërkesat e lartë cekura prej 1-5. Për secilin Lot që konkuron duhet ta caktoj me nga një vendim të posaqëm projekt menaxher të ndryshëm. Nëse ky kriter nuk plotësohet në këtë formë OE,do të eliminohet nga të gjitha Llotot pamvarsishtë se ai plotëson kushtet vetëm për një Lot të caktuar.	Dëshmia1-7 Për menaxherin e Projektit Personelin Kryesor Teknik të paraqiten Diplomat përkatëse të noterizuara , kontratat e punës , CV dhe letër referencë në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësit. Për udhëheqësin e punimeve dhe personelin teknik diplomat duhet të jetë te noterizuara. Dëshmia 6 mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapacitetve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), e noterizuar nga Noteri, O.E. duhet të sjell dëshmi librezat e mjeteve të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt duhet të verifikohen nga noteri.	
		Kërkesa-6 Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit a. Një (1) kamion për transport te materialit, b. Dy (dy) Ekskavator,vinq statik skeler mbajtes Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 apo me shume pjesë (lote), secilën Loto kërkohet dyfishimi i mjeteve të kerkuar nese konkuron në tri Loto duhet të trefishoj mjetet nese konkuron në katër loto Katër fishimi i mjeteve , Më kushte të njëjta si në Kërkesat e lartë cekura kërkesa e 6 .Për secilin Lot që konkuron duhet ta caktoj me nga një vendim të posaqëm projekt menaxher të ndryshëm. Nëse ky kriter nuk plotësohet në këtë	Dëshmia 6 mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapacitetve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit Njoftim per Kontrat 6 8 teknik në dosjen e tenderit), e noterizuar nga Noteri, O.E. duhet të sjell dëshmi librezat e mjeteve të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt duhet të verifikohen nga noteri.	

		formë OE,do të eliminohet nga të gjitha Llotot pamvarsishtë se ai plotëson kushtet vetëm për një Lot të caktuar.	
		Kërkesa 7 Projektet të ngjajshme të realizuara në tri vitet e shkuara nga data e publikimit të (Njoftimit për Kontrat),e vërtetuar nga OE,ku përfshihen titujt e projekteve,numri,data e kontraktimit dhe vlera,minimale duhet të jetë - Lot I- 2,250,000.00€. -- - Lot II- 1.950.000.00 €. - Lot III- 2,250,000.00€. Në rast të grupit për të gjitha Llotot Udhëheqësi duhet ti ketë së paku 60% të shumës së kërkuar punë të ngjajshme të realizuar në 3 vitet e fundit.	Dëshmia- 7 Lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin e kontratave në vlerë totale Lot I- 2,250,000.00€. Lot II- 1.950.000.00 €. Lot III- 2,250,000.00€. Të gjitha,referencat kopje të puneve të ngjajshme të realizuara në tri vitet e shkuara
		Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 apo me shume pjesë (lote), kontratave për punë qe kërkohet për Lotet për te cilat ai konkurron duhet të përmbushet nga OE. Shembull nëse shuma totale e kontratave për punë te kërkuara për Lot 1 është 2,250,000.00€ dhe për Lot 2 është 1.950.000.00 €, atëherë kërkesa minimale e kontratave te realizuara e cila duhet te përmbushet nga OE është 4.200,000.00 euro,ndersa nëse merr pjesë në tri Loto kërkesa minimale e kontratave te realizuara duhet të jetë 6.450.000,00 Nëse ky kriter nuk plotësohet në këtë formë OE,do të eliminohet nga të gjitha Llotot pamvarsishtë se ai plotëson kushtet vetëm për një Lot të caktuar	Dëshmia- 7 Lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin e kontratave në vlerë totale Lot I- 2,250,000.00€. Lot II- 1.950.000.00 €. Lot III- 2,250,000.00€. Të gjitha,referencat kopje të puneve të ngjajshme të realizuara në tri vitet e shkuara
		Kërkesa 8 Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se mesatarja e të punësuarve në tri vitet e fundit duhet të jetë minimum 15 punëtor Në rast se operatori ekonomik dorëzon tender për 2 apo me shume pjesë (lote), secilën Loto kërkohet dyfishimi i mjeteve të kerkuar nese konkuron në tri Loto duhet të trefishoj mjetet nese konkuron në katër loto Katër fishimi i mjeteve , Më kushte të njëjta si në Kërkesat e lartë cekura në kërkesën 8 Nëse ky kriter nuk plotësohet në këtë formë OE,do të eliminohet nga të gjitha Llotot pamvarsishtë se ai plotëson kushtet vetëm për një Lot të caktuar	Dëshmia- 8 Listën e pagave të operatorit ekonomik. Duhet të dorëzohet origjnali ose kopje e noterizuar
Krijimi i një grupi të operatorëve ekonomik	11.1	a. **një deklaratë e qartë** ku të gjithë anëtarët e grupit janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës për përmbajtjen e grupit të tenderit dhe, në rast se grupit i epet kontrata, për ekzekutimin e kontratës b. **një deklaratë të nënshkruar nga secili anëtarët**, duke konfirmuar pjesëmarrjen e tyre në grup dhe se ata nuk janë duke marrë pjesë ne mënyre individuale dhe/apo në ndonjë grup tjetër që marrin pjesë në procedurën e njëjtën të prokurimit; c. **një deklaratë të nënshkruar** nga të gjithë anëtarët e grupit të cilët autorizojnë partnerin kryesor për të vepruar në emër të grupit, dhe d. Të gjitha anëtar e grupit të tillë duhet të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshminë mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafin 6.4 të kësaj FDT.	
Nënkontraktimet	12.1	a. **një deklaratë** ku deklarojnë nënkontraktorët e zgjedhur për aktivitetin përkatëse të prokurimit, dhe b. Të gjithë kontraktorët do të **jenë të përshtatshëm** dhe do të sigurojnë dëshmi mbi përshtatshmërinë e tyre, siç është përmendur në paragrafit 6.4 të kësaj FDT.	
Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit: Po ☒ Jo ☐ *Nëse kërkohet sigurimi i tenderit:* Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit.	

	13.2	Vlera e sigurisë së tenderit **Lot I 45.000,00€ Lot II 39.000,00€ Lot III 45.000,00€** Vlefshmëria e sigurisë së tenderit ne ditë **120** apo muaj
Siguria e ekzekutimit	14.1	Siguria e kërkuar e ekzekutimit: Po ☒ Jo ☐ *[Nëse kërkohet siguria e ekzekutimit]* Në rast të dhënies së kontratës juve, ju duhet të postoni, para nënshkrimit të kontratës, sigurinë e ekzekutimit.
	14.2	Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është *[shëno shumën apo përqindjen në fjalë dhe figura]* apo **10%** për kohëzgjatjen e periudhës prej *[shëno kohëzgjatjen në ditë apo muaj]*.
Sqarimi i Dosjes së Tenderit	16.1	**08.05.2019**
Dokumentet qe përbejnë Tenderin	19.1(h)	*[Nëse është e aplikueshme shëno kërkesat tjera]*
Periudha vlefshmërisë së tenderit	21.1	Periudha e vlefshmërisë se tenderit do të jetë: **90** ditë, ose muaj, ose deri në datën .
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	23.1	Afati i fundit për dorëzim është je **17.05.2019 13:00:00** Vendi: **MASHT kati i III Zyra 310**
Hapja e Tenderit	26.1	Hapja e tenderit do te bëhet me **17.05.2019 13:00:00** Vendi: **MASHT kati i III Zyra 310**
Kriteret e Dhënies	30.1	Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët**]; ☒ apo [Tenderi i përgjegjshëm **ekonomikisht më i favorshëm** i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6 ☐
Ankesat	31.3	*[shëno adresën e AK-së]*

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

r.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (ëith VAT) Cena (sa PDV) €	Ndrysh imi/plc tësimi Suple ment/ Amenc ment Dpuna Izmjen a
.	**Consortium N.P.N. BAJRAMAJ ; ARBËRI -NS SH.P.K., SAVROVË, 23000, SUHAREKË**	**NPN-19**	**Construction of loëer secondary school in Talinoc of Muhaxherët Phase I, Ferizaj**	**YES**	**1017968.45**	**1241424.95**	**NO**
.	**Consortium CONSTRUMAX SH.P.K.; EBK SH.P.K.,**	**MA-CMX04**	**Construction of loëer secondary school in Talinoc of**	**YES**	**1186431.89**	**1399989.63**	**NO**

	Rr. Mentor Krasniqi p.n. Bukosh, 23000, Suharekë		Muhaxherët Phase I, Ferizaj				
	„ Engineering „SH.P.K., Rruga "UÇK" nr.28 (Te Qafa), 10000, PRISHTINË	1989	Construction of loëer secondary school in Talinoc of Muhaxherët Phase I, Ferizaj	YES	1100175.25	1298206.79	NO
	Consortium ALBA COMPANY SH.P.K.; N.N.T. A.B.C., Fatime Hetemi, 10000, Prishtine	208 Udheheqesi-19-2668-5-1-1	Construction of annex and renovation of elementary school in Zaskov-Ferizaj	YES	1231275.44	1452905.02	NO
	Consortium ALBA COMPANY SH.P.K.; N.N.T. A.B.C., Fatime Hetemi, 10000, Prishtine	208 Udheheqesi-19-2668-5-1-1	Construction of a school building in Doganaj - Kaqanik	YES	1630333.04	1923792.98	NO
	Consortium Edona Sh.p.k.; EUROING SH.P.K.; N.T.SH. Elektra, D.e Kombit Ban.e Solidaritetit, 70000, Kosovo	842035	Construction of loëer secondary school in Talinoc of Muhaxherët Phase I, Ferizaj	YES	1256548.50	1482727.23	NO
	Consortium N.P.T. Loni ; V - SHALA SH.P.K., ADEM JASHARI 169, -, PEJË	122019	Construction of annex and renovation of elementary school in Zaskov-Ferizaj	YES	1047957.32	1236589.64	NO
	Consortium N.N.SH. TOP PROJEKT ; ISEFERI SH.P.K., AGIM RAMADANI NR. 82/8- L. E UNIVERSITETIT, -, PRISHTINË	007	Construction of annex and renovation of elementary school in Zaskov-Ferizaj	YES	1160042.49	1368850.14	NO
	Consortium INFINIT ENGINEERING SH.P.K.; Avduli Përfaqësia ne Kosovë, Rruga B, 10000, Prishtine	2019/208 Udheheqesi-19-2668-5-1-1/B05-0007620	Construction of loëer secondary school in Talinoc of Muhaxherët Phase I, Ferizaj	YES	982723.83	1159614.12	NO
0	Consortium P&I SH.P.K.; ISEFERI SH.P.K., ELEZAJ, 71000, ELEZAJ	208udheheqesi-19-2668-5-1-1	Construction of a school building in Doganaj - Kaqanik	YES	972975.61	1148111.22	NO
1	" EURO - BESI " SH.P.K., Muharrem Fejza, -, PRISHTINË	MASHT3	Construction of annex and renovation of elementary school in Zaskov-Ferizaj	YES	1078150.63	1272217.74	NO
2	MERCOM COMPANY SH.P.K., 20/3 FAZLI GRAJÇEVCI, 10000, PRISHTINË	ROB34	Construction of a school building in Doganaj - Kaqanik	YES	1069007.33	1261428.65	NO
3	Consortium N.P.N. ALPING ; „ ENGRUP	a-01	Construction of loëer secondary	YES	1081063.37	1275654.78	NO

	SH.P.K.; ALPING SH.P.K.; N.T. FLAMURI ; FLAMURI V SH.P.K., FUSHA E QERKEZËVE, -, HAJVALI		school in Talinoc of Muhaxherët Phase I, Ferizaj				
4	Consortium Arhiko .ING O.P.; LUBOTENI-A SH.P.K.; N.T.SH. AR - DRITI, B. Diellit, Z. Lindjes A11/13, 10 000, Prishtine	MA1705	Construction of a school building in Doganaj - Kaqanik	YES	996714.39	1148755.59	NO
5	Consortium Termomontimi shpk; DAJTING SH.P.K., Zona Industriale, 10000, Prishtine	208 Udheheqesi-19-2668-5-1-1	Construction of loëer secondary school in Talinoc of Muhaxherët Phase I, Ferizaj	YES	1216667.34	1435667.46	NO
6	Consortium: N.N."PRISHTINA"; " DIAMANTI " SH.P.K., LUAN HARADINAJ SOL.-AVALLA B8/12, -, PRISHTINË	208019019511	Construction of a school building in Doganaj - Kaqanik	YES	1002984.65	1183521.88	NO
7	NPN EUROING SH.P.K., Xhelal Hajda -Toni, 21000, RAHOVEC	17/05/2019	Construction of annex and renovation of elementary school in Zaskov-Ferizaj	YES	1079495.45	1273804.64	NO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Musa Shala– Kryetar i komisionit
Valon Alimusa– Anëtar i komisionit
Vjollca Camaj Fejza – Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Lideri i Grupit të Operatorëve Ekonomik "AVDULI" sh.pk. me seli në Prishtinë, dega në Kosovë, më parë ka pasur të nënshkruar kontratë me MASHT, "Ndërtimi i murit mbrojtës në Kaçanik" me nr. të Prokurimit; MASHT/12/053/511, të cilën kontratë OE në fjalë nuk e ka përmbushur ende, qe nga viti 2012. Menaxheri i kontratës, ka parashtruar dhjetra kërkesa drejtuar kontraktuesit në fjalë për ta përmbushur kontratën. Njëjt menaxheri i kontratës ka bërë një rekomandim për shkëputjen e kontratës së lartëcekur, pasi që konsideron se OE nuk dëshiron përmbushjen e kontratës.

- Grupi i OE, kanë prezantuar staf profesional, ku si dëshmi ka prezantuar Diploma të cilat janë të lëshuara nga Institucionet e Arsimit të Lartë në Shqipëri. Asnjëra nga diploma e stafit profesional nuk është e Nostifikuar në Kosovë, me çka i bënë të pavlefshme pasi që nuk kanë të drejtë të ushtrojnë

veprimtarinë profesionale person me diplomë të huaj pa ju nënshtruar procedurës së verifikimit dhe nostifikimit të kualifikimit shkollor përkatës.

- Lideri i konzorciumit nuk ka prezantuar asnjë referencë të lidhur me përmbushjen e kontratave në 3 vitet e fundit në Kosovë, të gjitha referencat e prezantuara janë të kontratave të realizuara në Shqipëri.

Duke u bazuar në të gjetuarat qe u ceken më lartë, dhe mos përmbushjen e kontratës të lartcekur, në mënyrë të papërgjegjshme dhe të pa arsyeshme qe ka me institucionin tonë, ne si AK e konsiderojmë ofertën të papërgjegjshme dhe eliminohet nga procedura e prokurimit.

Përgjigjje në pretendimet ankimore të OE ankues "Infinit&Avduli Përfaqësia në Kosovë"-Prishtinë

Përgjigjje nëPretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e parë ankimorë, dhe arsyen e dhënë nga AK se OE nuk ka përmbushur një kontratë të mëhershme me AK-MASHT, ky pretendim ankimorë i OE ankues është i bazuar, pasi që AK nuk ka dhënë asnjë dëshmi që konform nenit 65 të LPP-së ky OE është i pa pranueshëm.

AK nuk e ka autorizimin që vet ta shpall një OE si të pa pranueshëm, dhe kjo duhet të konstatohet nga gjykata kompetente, e që në rastin konkret një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

Andaj eliminimi i OE me arsyetim të dhënë si më lart është në kundërshtim me dispozitat e nenit 65 të LPP-së.

Përgjigjje në Pretendimi nr.2

Lidhur me pretendimin e dytë ankimorë se OE ankues nuk ka ofruar diploma të nostrifikuara, pretendimi ankimorë është i bazuar sepse nostrifikimi i diplomave nuk ka qenë kërkesë në njoftim për kontratë apo dosje të tenderit dhe një vlerësim i tillë nga AK paraqet shkelje të nenit 56 të LPP-së konkretisht neni 56 par. 3 ku decidivisht thuhet se OE "*Nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit*".

Me këtë rast AK-MASHT po ashtu ka bërë shkelje të nenit 7 par.4 të LPP-së, ku qëllimi i këtyre dispozitave ligjore është të sigurohet barazia në trajtim të OE pavarësisht vendit apo territorit prej nga vjen OE.

Citat i i nenit 7 par.4 :

*"Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë **ose imponojë** dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të **parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave** ose kushteve **që rezultojnë në diskriminim territorial**, fizik, material, **personal ose organizativ** ndërmjet operatorëve ekonomik".*

Përgjigjje në Pretendimi nr.3

Lidhur me pretendimin ankimorë, dhe eliminimin e OE me arsyetim se lideri i ka ofruar referencat për punë të kryera nga Shqipëri, prap kjo paraqet shkelje të nenit 7 par.4 të LPP-së, dhe një vlerësim i tillë nuk është i bazuar në asnjë dispozitë të LPP-së, dhe pretendimi ankimorë i OE ankues është i bazuar.

Përgjigjje në Pretendimi nr.4

Lidhur me pretendimin ankimorë se AK-MASHT nuk i la lejuar qasje OE ankues në dokumenet e këtij tenderi, pas qasjes në platformën E-Prokurimit, kam gjetur një kërkesë të OE për qasje në dokumentacion , kërkesa e bërë me datë 03.06.2019, mirëpo nuk kam gjetur dëshmi se AK i ka lejuar një qasje të tillë. Kjo paraqet shkelje të nenit 10 par.3 dhe par.4 të LPP-së.

Përgjigjje në Pretendimi nr.5

Lidhur me pretendimin ankimorë për vendimin e AK-së në kërkesë për rishqyrtim, fillimisht sqarojmë se AK nuk ka dhënë asnjë arsyetim të bazuar në dispozita ligjore mbi eliminimin e OE, duke konstatuar thjesht se "*të gjitha pretendimet ankimore janë të pabazuara*".

Për më tepër, AK në kundërshtim me nenin 108/A par.8 nënpar.8.4, në vendim të kërkesës për rishqyrtim gjenë edhe arsye tjera për eliminim të OE, duke konstatuar se dy certifikata janë të paafatshme.

Pas qasjes në platformën E-Prokurimi dhe qasjes në ofertën e OE ankues, kemi hasur se të dy certifikatat e OE ankues që gjenden në ofertën e tij e që janë kontesutuar nga AK, datën e skadencës e kanë me 10.04.2020.

Provë:

1. Kopja e certifikatës ISO 27001:2013 - (data skadencës) 10/04/2020
2. Kopja e certifikatës SA 8000:2014 - (data skadencës) 10/04/2020

AK në arsyetimin e vendimit për rishqyrtim thotë se disa certifikata që janë ofruar "*në dokument figurojnë ndryshe sistem ndryshe*", me gjithë atë i vetmi dokument zyrtar me vulë, nënshkrim dhe datë të lëshimit janë vet certifikatat e ofruara nga OE.

Nëse AK ka pas dyshime në validitetin e këtyre certifikatave, atëher mendoj se një konstatim i tillë mund të bëhet vetëm nëse vërtetohet se data e skadencës në certifikatë është ndryshuar, e që në rastin konkret një gjë e tillë nuk ka ndodhur.

PO ashtu mendoj se shumë me rëndësi është fakti se gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim AK nuk ka pas të drejtë ligjore të lëshohet në shqyrtim të pikave të cilat nuk kanë qenë pjesë e raportit e vlerësimit-elimimit të OE, e që rrjedhimisht nuk kanë qenë as pika të kërkesës për rishqyrtim të OE ankues.

Neni 108/A, par.8 nënpar.8.4 i LPP-së decidivisht e ndalonë marrjen e vendimit nga AK jashtë kërkesave të ankesës të OE , citat nga neni 108/A par.8 nënpar.8.4 :

Par.8 - Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur:

*8.4 - autoriteti kontraktues ka shqyrtuar vendimin e tij **në kuptimin e asaj që kërkohet nga ankuesi**.*

Në rastin konkret AK-MASHT **nuk** e ka shqyrtuar vendimin e tij në kuptimin e asaj që është kërkuar nga ankuesi andaj vlerësojmë se ky pretendim ankimorë është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues **të aprovohet e bazuar** (për arsyet që u ceken tek përgjigjjet në pretendimet ankimore),ndërsa rekomandon qëanulohet vendimii AK-së dhe lënda të kthehet në Rivlerësim.